



BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE

PËR VITIN 2026

Draft final

Prishtinë, shkurt 2026

PËRMBAJTJA E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË TERMIKE

HYRJE	3
SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE	3
Historiku	3
Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike.....	4
Përshkrimi i rrjetit të shpërndarjes.....	5
Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike	6
Projektet nga donacionet dhe me vetëfinacim të planifikuara për vitin 2026.....	8
PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË TERMIKE	11
HUMBJET NË RRJET	12
PLANI I FURNIZIMIT TË KONSUMATORËVE ME ENERGJI TERMIKE	15
Metodologjia.....	15
Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës për energji termike	15
PËRMBLEDHJA E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË TERMIKE PËR VITIN 2026	18

HYRJE

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike, është përpiluar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (neni 8) dhe "Rregullën dhe metodologjinë për përgatitjen e balanceve të energjisë elektrike dhe termike", ku specifikohet se Bilanci vjetor zhvillohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria e Ekonomisë, dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregulatorit për Energji (ZRRE).

Ky dokument hartohet në formatin sipas kërkesës se "Rregullës dhe metodologjisë për përgatitjen e balanceve të energjisë elektrike dhe termike", ku paraqitet planifikimi për një periudhë sezonale (vjetore) të kërkesës për energji termike dhe prodhimit të nevojshëm të parashikuar për të plotësuar këtë kërkesë. Gjithashtu janë bërë edhe parashikimet për humbjet në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike.

Të dhënat e paraqitura në "Bilancin vjetor të energjisë termike për vitin 2026", janë të bazuara në të dhënat historike të sezonave të fundit, në projeksionet zhvillimore aktuale, dhe në dokumentet (strategjitë, studimet) relevante. Prandaj, të dhënat e paraqitura mund të konsiderohen se kanë saktësi dhe besueshmëri relative.

SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE

Historiku

NP "Termokos" Sh.A. është furnizuesi i vetëm i ngrohjes qendrore në Prishtinë. Krahas ngrohjes qendrore, NP "Termokos" Sh.A. gjithashtu ofron edhe shërbime të mirëmbajtjes të sistemit të ngrohjes qendrore për konsumatorët e saj. Kërkesa për ngrohje qendrore të ofruar nga NP "Termokos" Sh.A. është jashtëzakonisht e lartë, kjo për arsye se NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje kualitative 24 orë gjatë gjithë sezonit ngrohës dhe me çmim më të lirë se sa alternativat tjera të ngrohjes.

Aktualisht, NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje qendrore për 25,283 konsumator (prej të cilëve 22,921 janë konsumatorë banesorë dhe 2,362 konsumatorë afarist e institucional). Përderisa, numri i konsumatorëve potencial që parashihet të kyçen në sistemin e ngrohjes qendrore të NP "Termokos" Sh.A në vitin 2026, është përafërsisht 2,400 konsumatorë, prej të cilëve 2,000 konsumatorë shtëpiak dhe 400 konsumatorë komercial, që i takojnë Lagjes Lakrishtë dhe ky investim do të financohet nga Termokosi si vetfinancues i projektit.

NP "Termokos" Sh.A. mbulon kërkesën për ngrohje të konsumatorëve ekzistues duke mos shfrytëzuar tërësisht kapacitetin ekzistues. Kjo dërgon drejt konkluzionit që NP "Termokos" Sh.A., mund të ofrojë ngrohje qendrore për konsumatorë të rinjë të cilët mund të kyçen në rrjetin e NP "Termokos" Sh.A.

Lidhur me këtë fakt, nga studimi i Masterplanit të përditësuar 2025 (studimi i zgjerimit të rrjetit) i realizuar nga konsulenca e angazhuar, lidhur me rezervën energjetike, del se kapacitete të lira mbesin rreth 25MW_{TH}, pas të gjitha masave që janë ndërmarrë për:

- Rehabilitimin e rrjetit,
- Zgjerimin e rrjetit,
- Faturimit me matje-shfrytëzimi efikas i ngrohjes/kursimi i energjisë termike,
- Rezervuarëve të nxehtësisë.

Prandaj, këtë kapacitet NP "Termokos" Sh.A. ka planifikuar që t'a shpërndajë në zgjerimin e rrjetit në lagjen Lakrishtë dhe Bregu i Diellit II.

Për lagjen "Bregu i Diellit II" ka qenë e paraparë zgjerimi i rrjetit dhe kyçja e "Banesave të Bardha", në kuadër të një projekti më të gjerë të bashkëfinancuar me Komunën e Prishtinës. Mirëpo, për shkaqe objektive nuk është realizuar financimi nga Komuna e Prishtinës dhe si rrjedhojë ky projekt është shtyer për një kohët të pacaktuar.

Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike

Njësi bazë gjeneruese e energjisë termike është TC Kosova B, përmes sistemit të koogjenerimit. Kapaciteti i instaluar është 140 MW_{TH}, ndërsa kapaciteti operativ vlerësohet të jetë 137.48 MW_{TH}. Për prodhimin e energjisë termike shfrytëzohet avulli i cili ekstrahohet nga shkalla e PM e të dy turbinave në këtë termocentral. Këmbimi i energjisë avull/ujë, bëhet në stacionin për ekstraktim të energjisë HES përmes dy këmbyesve me kapacitet nga 70 MW_{TH}. Ky stacion është në afërsi të TC Kosova B, dhe në tërësi menaxhohet nga Termokosi.

Tabela 1. Kapacitetet e prodhimit të energjisë termike nga koogjenerimi

Njësia gjeneruese	Kapaciteti i instaluar	Kapaciteti total	Viti i prodh./instalimit	Vendi
Sistemi i koogjene.-TC Kosova B	2x70 MW	140W	2014	TC Kosova B

Termokosi disponon edhe me kapacitete të veta të prodhimit të energjisë termike me kaldajat me lëndën djegëse mazut, të cilat janë përdorur para funksionalizimit të sistemit të koogjenerimit. Këto kapacitete prodhuese kanë qenë të planifikuara si kapacitet rezervë për t'u përdorur në raste specifike (në rast të ndërprerjes së furnizimit nga KEK – TC Kosova B dhe mbulimi i kërkesës për energji në pikun e ngarkesës).

Mirëpo, duke marrë parasysh vjetërsinë e kaldajave ekzistuese, gjendjen e keqe teknike të tyre, vitet e mosfunksionimit të tyre (që nga funksionalizimi i sistemit të koogjenerimit), etj, Termokos ka angazhuar ekspertë të specializuar në fushën përkatëse nga Fakulteti Teknik (FIM dhe FIN) të UP, të cilët kanë bërë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të kaldajave, oxhakut dhe rezervuarëve të mazutit (R₃ dhe R₄).

Andaj, bazuar në rekomandimet dhe konkludimet e grupit të ekspertëve të angazhuar sipas "Raportit për vlerësimin profesional të dy kaldajave, rezervuarëve të mazutit dhe oxhakut" (me Nr. Prot. 081 të datës 26.06.2024), grupi i ekspertëve pas një vlerësimi të hollësishëm, konstatojnë se kaldajat ekzistuese kanë pësuar dëmtime të rënda në strukturën e tyre mekanike, elektrike dhe ndërtimore.

Dëmtimet janë të atilla që operimi i tyre i sigurtë dhe efikas është i pamundur dhe çdo përpjekje për riparimin e tyre është e padobishme.

Prandaj, bazuar në këtë konstatim, dhe gjithashtu duke marrë parasysh edhe kushtet dhe normat e sigurisë dhe të ndotjes së ambientit (me përdorimin e mazutit), rekomandimi i grupit të ekspertëve është që kaladajat ekzistuese të zëvendësohen më kaldaja të reja më gaz.

Rezervuar të mazutit të cilët kanë pësuar dëmtime nga korrozioni, duhet të zëvendësohen me pajisje mobile për sistemin e kaldajave me gaz, duke përdorur cisterna sipas kërkesës, ndërsa oxhaku duhet të riparohet nëse përdoret për gazëra dalëse.

Në tabelën 2. janë paraqitur kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike me të cilat disponon NP "Termokos" sh.a.

Tabela 2. Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike

Njësia gjeneruese	Kapaciteti i instaluar	η (%)	Kapaciteti operativ	Lënda djegëse	Kons.l.d. Kg/MWh	Viti i prodhimit /instalimit	Vendi i instalimit
Sistemi i kogjenerimit TC Kosova B	$2 \times 70 = 140$ MW _{TH}	98	137.48 MW _{TH}	Linjit	-	2014	TC Kosova B
Kaldajat me ujë të nxehtë	$2 \times 58 = 116$ MW _{TH}	n/a	n/a	Mazut	n/a	1978	Termokos
	$2 \times 7 = 14$ MW _{TH}	85	11.9 MW _{TH}	Dizel	96	1983	Ngrohtorja e QKUK
	4 MW _{TH}	90	3.6 MW _{TH}	Mazut	96	2003	Termokos
Total kapaciteti i instaluar vetëm në ngrohtore * Nuk përfshihen kapacitetet e kogjenerimit	134 MW _{TH}	87.5	16.2 MW _{TH}	-	-	-	-
Total kapaciteti gjenerues	274 MW _{TH}	93	153.68 MW _{TH}	-	-	-	-

Përshkrimi i rrjetit të shpërndarjes

Rrjeti primar i shpërndarjes me gjatësi të tubacionit prej 120 km dhe kapacitet të ujit rreth 4,500 m³, është i instaluar në pjesën e urbanizuar të Prishtinës. Pas investimeve intensive në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit, posaçërisht në vitin e fundit, është arritur që rreth 97% e rrjetit të shpërndarjes të jetë me gypa të rinjë të paraizoluar kurse pjesa tjetër me gypa të amortizuar.


Përshkrimi i karakteristikave kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 3. Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes

Rrjeti i shpërndarjes dhe nënstationet - NP "Termokos" Sh.a.		
Numri i nënstationeve	Gjatësia e rrjetit(km)	Numri i matësve në termonënstacione
935	120	Nga 935 nënstatione, 915 nënstatione janë të pajisur me matës funksional, kurse 20 nënstatione (kryesisht nënstatione të vogla për nga kapaciteti) pa matës.
920 aktive		
15 pasive		

Në figurën 1. është paraqitur skema e rrjetit aktual të shpërndarjes së energjisë termike.

Figura 1. Shtrirja e rrjetit të ngrohjes qendrore të NP"Termokos"Sh.A në Prishtinë



Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike

NP "Termokos"Sh.A, planet afatgjata për prodhimin të energjisë termike i bazon në sistemin e koogjenerimit, si burim i sigurt, ekonomikisht i favorshëm dhe i përshtatshëm

në kuptim të mbrojtjes së ambientit, si dhe në impiantin e përfitimit të energjisë termike nga energjia diellore.

Kapaciteti aktual prej 140MW_{TH} (2x70 MW_{TH}) dhe aftësia bartëse e termopërquesit (Rrjetit të transportit të energjisë termike) TC Kosova B – Termokos prej 160 MW_{TH}, janë faktorë limitues për ekstraktim më të madh energjisë.

Prandaj, planet zhvillimore të Termokosit bazohen në dyfishimin e kapaciteteve prodhuese nga koogjenerimi në TC Kosova B nga 140MW_{TH} në 280MW_{TH} (nga të cilat 40 MW_{TH} do të ndahen për komunën e Obiliqit, ndërsa 100MW_{TH} do të mbeten për Termokos), që pritet të hyjë në funksion nga sezona ngrohëse 2028/2029. Gjithashtu edhe kapaciteti i përfitimit të energjisë termike nga energjia diellore përmes projektit “Solar 4 Kosova II”, me kapacitet prej 50MW_{TH}, që pritet të funksionalizohet nga sezoni 2028/2029.

Bazuar në donacionet dhe investimet me mjete vetanake të NP “Termokos”Sh.A, viteve të fundit janë bërë investime të mëdha në zgjerimin e rrjetit dhe rehabilitimin e sistemit të ngrohjes qendrore. Poashtu edhe viteve në vijim pritet të ketë investime të mëdha për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes, që rezulton në rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore.

Detajet janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Në tabelat 4, 5 dhe 6, janë paraqitur projeksionet për planifikimin e zgjerimit të sipërfaqes ngrohëse, në të cilën sipërfaqja e paraqitur është sipërfaqe aktive (sipërfaqe e cila do të faturohet). Kjo ndodhë për shkak se në ndërtesat e kyçura në rrjetin e ngrohjes qendrore, mbi 50% e apartamenteve të kyçura janë të pabanuara, që zakonisht janë në pronësi të bashkëatdhetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit dhe të cilët kërkojnë të shkyçen, e që rrjedhimisht nuk hyjnë në proces të faturimit.

Tabela 4. Skenari 1. Projeksioni i Ulët

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m2	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m2	Sipërfaqja totale e kyçur /m2
2026	1.5-2.0	150,000.00	2,269,357.00	2,419,357.00
2027	1.7-2.5	130,000.00	2,419,357.00	2,549,357.00

Tabela 5. Skenari 2. Projeksioni i Mesëm

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m2	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m2	Sipërfaqja totale e kyçur /m2
2026	2-3.5	170,000.00	2,269,357.00	2,439,357.00
2027	2-3	150,000.00	2,439,357.00	2,589,357.00

Tabela 6. Skenari 3. Projeksioni i Lartë

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m2	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m2	Sipërfaqja totale e kyçur /m2
2026	2.5-3.8	190,000.00	2,269,357.00	2,459,357.00
2027	3.0-4.0	170,000.00	2,459,357.00	2,629,357.00

Zgjerimi i sipërfaqes i planifikuar për vitin 2026, planifikohet të realizohet bazuar në investimet me vetëfinancim nga "NP"Termokos"Sh.A për lagjen Lakrishtë (objektet shumëkatëshe).

Projektet nga donacionet dhe me vetëfinancim të planifikuara për vitin 2026

Sa i përket projekteve nga donacionet dhe me vetëfinancim të planifikuara për vitin 2026, kemi parqitur projektet të cilat janë në fazën e zhvillimit dhe projektet të cilat planifikohet të fillojnë të realizohen gjatë vitit 2026. Në kuadër të kësaj janë planifikuar projektet me donacione dhe me vetfinancim, e të cilat janë :

1. Projekti për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore dhe termonënstacioneve,
2. Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova II",
3. Vazhdimi i zhvillimit të fazës së dytë të projektit "Prishtina Heat Save" për instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese tek konsumatorët e Termokosit .

Në vijim do të parqiten detaje lidhur me tre projektet e listuara:

1. Projekti për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore dhe termonënstacioneve

Për vitin 2026, në kuadër të zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore, parashikohet realizimi i punimeve për "Projektin për kyçjen në rrjetin e ngrohjes dhe lagjes "Lakrishtë" . Kostoja e parashikuar për realizimin e projektit është rreth 2.3 mil. euro e cila do të financohet me fondet e Termokos-it.

Ky projekt përfshinë kyçjen në rrjetin e ngrohjes të objekteve / lagjes:

- Lagja Lakrishtë (objektet shumëkatëshe).

Prandaj, në skenarët e zgjerimit të sipërfaqes në kuadër të zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore, planifikohet realizimi i punimeve për kyçjen e lagjes "Lakrishtë" (objektet shumëkatëshe), në kuadër të të cilit do të kyçen në rrjetin e ngrohjes qendrore 15 objekte me sipërfaqe prej 402,202.00 m². Lidhur me këtë projekt, në vitin 2025 është zgjedhur kompania për zgjerimin e rrjetit dhe janë duke u zhvilluar punimet për shtrirjen e rrjetit të termopërquesit në kuadër të zgjerimit të rrjetit në lagjen "Lakrishtë" (objektet shumëkatëshe).

Ndërsa për "Nënstacionet termike ", meqenëse në fazën e parë tenderuese, tenderi është anuluar për shkak të procedurave të prokurimit, së shpejti pritët procesi i ritenderimit.

2. Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova II"

Projekti për prodhimin e energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova II", është projekti më i madhi në Ballkan dhe i dyti në Evropë pas Danimarkës, në fushën e energjisë diellore.

Projekti përfshinë ndërtimin e impiantit termik diellor dhe integrimin në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore duke përfshirë zgjerimin e rrjetit deri në 50MW_{TH}. Bazuar në raportet e përditësuara 2025, ky projekt parashihet të ketë koston në vlerë prej rreth 87.71 milion euro.

Projekti "Solar 4 Kosova II" do të financohet nga; WBIF me 21.5milion euro grant, KfW me 31.6 milion euro kredi, EBRD me 23 milion euro kredi dhe nga NP "Termokos"Sh.A 11,61 milion euro si bashkëfinancues i këtij projekti.

Në kuadër të këtij projekti, do të vendosen panelet diellore prej 63,000 m², gjë që do të ndikojë në rritjen e kapacitetit termik për 50MW_{TH}, duke mundësuar zgjerimin e rrjetit dhe kyçjen në rrjetin e ngrohjes edhe për rreth 8,600 konsumatorë të rinj në lagjet (Lakrishtë, Tophane, Gjinaj dhe Mahalla e Muhaxherëve). Pjesë e projektit është edhe ndërtimi i rezervuarit sezonal të energjisë termike (PTES- Pit Thermal Energy Storage) me kapacitet prej 380,000m³ ujë, pompa termike absorbuese (AHP) dhe sistemi SCADA.

Ky projekt është në zhvillim dhe ka arritur në disa faza të rëndësishme:

- **Aprovim i Raportit për Planin e Projektit (PPR-Project Planing Report):** Raporti është miratuar dhe përmbanë të gjitha detajet teknike të projektit, duke përfshirë specifikimet teknike, procedurat dhe metodologjitë që do të ndiqen gjatë implementimit,
- **Plani i prokurimit:** Plani i prokurimit është përgaditur dhe përcakton strategjitë për blerjen e shërbimeve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit, duke siguruar transparencë dhe konkurrencë në procesin e blerjes.
- **Dokumenti i parakualifikimit (PQ):** Ky dokument është përgaditur si fazë para publikimit të tenderit, duke përfshirë kriteret dhe kërkesat për ofertuesit potencial. Kjo do të lehtësojë procesin e seleksionimit të kontraktuesve që do të angazhohen për projektin. Meqenëse Tenderi i parë për parakualifikim (PQ) është anuluar, ritenderimi do të rishpallet brenda muajit nëntor 2025 dhe planifikohet që kontraktimi të bëhet në muajin prill 2026.
- **Masterplani për zgjerimin e rrjetit në kuadër të projektit;** Plani i zgjerimit të rrjetit që përfshinë detajet e strategjive për integrimin e energjisë solare në rrjetin ekzistues të ngrohjes, është aprovuar. Kjo do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të sistemit të ngrohjes.
- **Dokumentacioni për leje mjedisore dhe ndërtimore;** jemi në fazën e përgaditjes së dokumentacionit të nevojshëm për lejen mjedisore dhe kushtet ndërtimore, si dhe procedurat e shpronësimit të parcelave të nevojshme për ndërtimin e impiantit. Ky është një hap i rëndësishëm për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret dhe standardet e mjedisit.

Prandaj ky projekt është paraqitur në "Bilancin vjetor të energjisë termike për vitin 2026" duke u bazuar në faktin se:

- Publikimi i tenderit për zgjedhjen e kompanisë punëkryese, planifikohet të bëhet në muajin nëntor 2025.
- Përzgjedhja e kompanisë punëkryese planifikohet të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2026, dhe brenda gjatëmuorit të parë të 2026 pritët të fillojë zhvillimi i punimeve për ndërtimin e impiantit.

Gjithashtu gjatë vitit gjatë vitit 2026 lidhur me këtë projekt planifikohet :

- Finalizimi i projektimit të detajuar teknik për fushën e kolektorëve, rezervuarit sezonal të energjisë termike (PTES- Pit Thermal Energy Storage) dhe nënstacionet.
- Përfundimi i procedurave të shpronësimit dhe sigurimi i të gjitha lejeve nga autoritetet komunale dhe qeveritare.
- Nisja e punimeve përgatitore në terren, përfshirë hapjen e gropës për rezervuarin sezonal të energjisë termike (PTES- Pit Thermal Energy Storage) dhe ndërtimin e infrastrukturës bazë.
- Përgatitja e kontratave me kontraktorët dhe furnitorët kryesorë.

3. Projekti "Prishtina Heat Save" për instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese

Gjatë vitit 2026 do të vazhdojë zhvillimi i fazës së dytë të projektit "Prishtina Heat Save" për instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese, dhe për këtë qëllim Termokosi në buxhetin e vitit 2026 ka ndarë 0.5 milion euro. Ky projekt do të financohet nga mjetet vetanake të NP "Termokos" Sh.a

Synohet që gjatë vitit 2026 të arrihet një përqindje sa më e lartë e instalimit të pajisjeve matëse dhe rregulluese në objektet në të cilat nuk janë përfunduar plotësisht instalimet në fazën e parë, duke vazhduar instalimet edhe në objekte të reja, për aq sa mjafton buxheti i planifikuar.

Termokos është duke shqyrtuar mundësinë e gjetjes së donatorëve për mbështetje financiare për zgjerimin e këtij projekti në të gjitha lagjet ku shtrihet rrjeti i ngrohjes qendrore, në mënyrë që të krijohet mundësia që të gjithë konsumatorët të faturohen në bazë të konsumit.

Qëllimi i realizimit të këtij projekti është që faturimi i konsumatorëve të NP "Termokos" Sh.A. në Prishtinë të kalojnë nga faturimi në bazë të sipërfaqes ngrohëse në faturim në bazë të konsumit të matur, gjë që do të mundësojë:

- Kontrollimin e konsumit të energjisë termike nga konsumatori ,
- Kursimi i energjisë termike,
- Zgjerimi i rrjetit të Termokos (nga kapacitetet e kursyera), për të rritur numrin e konsumatorëve të cilët janë duke shfrytëzuar energjinë elektrike për ngrohje.
- Termokos të ofrojë shërbime inovative për konsumatorët e saj,
- Mbrojtja e mjedisit, etj.

Realizimi i këtij projekti përkitazi me numrin e apartamenteve në të cilat janë instaluar paisjet matëse dhe rregulluese dhe sasinë e pajisjeve të instaluara deri në muajin shtator 2025 që nga fillimi i projektit, është paraqitur në tabelën 7.

Tabela 7. Sasia e instalimeve hidraulike e realizuar për projektin "Prishtina Heat Save" deri në muajin shtator 2025.

Rajoni	Numri i apartamenteve të instaluara	Valvulat termostatike	Alokatorët	Njehsorët e nxehtësisë	Pompat qarkulluse	Valvulat balancuese
Arbëri	937	3,731	1,343	149	37	
Bregu i Diellit	2,643	13,076	11,829	37	39	
Dardania	3,190	13,997	14,122	0	23	
Kalabria	1,647	6,961	3,785	701	132	18
Mati 1	7,088	23,583	12,573	3,727	4	
Qendër	3,284	13,730	10,743	793	0	
Ulpianë	2,300	8,942	7,860	0	0	
Total:	21,089	84,020	62,255	5,407	235	18

PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË TERMIKE

Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin). Gjithashtu planifikimet për prodhimin e energjisë termike reflektojnë edhe humbjet në rrjet, si dhe eficiencën e energjisë.

Siç është cekur më lartë, NP "Termokos" Sh.A prodhimin e energjisë termike e bazon në stabilimentet e koogjenerimit në TC "Kosova B" me kapacitet nominal prej 140MW_{TH}.

Ndërsa, impiatët për prodhimin e energjisë termike të instaluar në NP "Termokos" Sh.A, (dy kaldajat me mazut me kapacitet 116MW_{TH}), nuk janë funksionale (të vlerësuara nga ekspertët e angazhuar nga FM dhe FN të Universitetit të Prishtinës, e sqaruar në faqen 5. të këtij dokumenti).

Kështu që, për vitin 2026 nuk është planifikuar prodhim i energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrohtore me mazut për këto arsye:

1. Stacioni i mazutit (i vjetri) është larguar për shkak të ndërtimit të objektit të ri administrativ në të njëjtin lokacion.
2. Bazuar në raportin e ekspertëve të Fakultetit Teknik (FIM dhe FIN) të UP (i cekur më lartë), mbi gjendjen aktuale të dy kaldajave ekzistuese me kapacitet 116MW, ku është konstatuar se këto kaldaja nuk janë funksionale për të prodhuar energji termike.

Në tabelën 8. janë paraqitur parashikimet vjetore (për vitin 2026) të prodhimit bruto të energjisë termike nga kogjenerimi dhe nga kapacitetet e prodhuese të ngrohtores.

Tabela 8. Prodhimi bruto vjetor i energjisë termike 2026

Prodhimi bruto i energjisë termike për vitin 2026	
Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi (MWh _{TER})	366,590
Prodhimi i energjisë termike në Ngrohtore (MWh _{TER})	0

Total bruto prodhimi(MWh_{TER})	366,590
---	----------------

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat për prodhimin bruto dhe neto të energjisë termike nga disponueshmëria e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë termike, sipas muajve për vitin 2026.

Tabela 9. Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike sipas muajve për vitin 2026

PRODIMI I ENERGJISË TERMIKE - 2026								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Mesatare
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	0	0	0	0	0	0	0	0
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (MWh)	0	0	0	0	0	0	0	0
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	70,327	61,556	55,982	22,073	23,826	61,311	71,515	366,590
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	70,327	61,556	55,982	22,073	23,826	61,311	71,515	366,590
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	1,407	1,231	1,120	441	477	1,226	1,430	7,332
Konsumi vetanak (MWh)	95	90	60	40	60	75	85	505
Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)	68,826	60,235	54,802	21,591	23,289	60,010	70,000	358,753

HUMBJET NË RRJET

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportit të energjisë termike (TC Kosova B – NQ Termokos) dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.


Historiku i humbjeve të përgjithshme të energjisë termike (humbjet në rrjetin e transportit dhe shpërndarjes së energjisë termike) për tri sezonat e kaluara 2022/2023, 2023/2024 dhe 2024/2025, është paraqitur në tabelën 10.

Tabela 10. Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjetin e transportit dhe shpërndarjes së energjisë termike

Sezoni	Të prodhuara nga kogjenerimi dhe në ngrohtore	Të liferuara	Humbjet e përgjithshme në rrjet	
	MWh _{TH}	MWh _{TH}	MWh _{TH}	në %
2024/2025	359,816	325,862	33,953	9.4
2023/2024	329,617	285,728	43,525	13.2
2022/2023	308,204	270,582	36,766	11.9

Sqarim: Nga ndryshimi në mes energjisë së prodhuar dhe të liferuar, është zbritur konsumi vetanak.

Fig.2 Diagrami i humbjeve të energjisë termike gjatë tre sezonave ngrohëse



Humbjet e ujit

Humbjet e përgjithshme të ujit në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transportit të energjisë termike, gjatë sezonit ngrohës 2024/2025 kanë qenë gjithsej 93,473 m³ apo 7.13% më të mëdha se sa në sezonin e kaluar 2023/2024. Ndërsa, krahasuar me sezonin 2022/2023, humbjet e ujit në këtë sezonë janë rritur për 35%. Më poshtë, janë paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike humbjet e ujit për tre sezonat e kaluara ngrohëse 2024/2025, 2023/2024 dhe 2022/2023.

Tab. 11 Humbjet e ujit m³ në tre sezonat ngrohëse 2024/2025, 2023/2024 dhe 2022/2023

Humbjet e ujit/ m3	Sezona 2024/2025	Sezona 2023/2024	Sezona 2022/2023
tetor	16,969	14,105	8,678
nëntor	15,062	12,324	10,115
dhjetor	13,507	14,163	11,048
janar	11,447	16,187	10,179
shkurt	10,868	11,233	9,066
mars	11,753	9,445	10,777
prill	13,867	9,979	9,312
Total	93,473	87,254	69,175


Në këtë ngritje të nivelit të humbjeve të (ujit) kanë ndikuar këta faktorë:

- Është zgjeruar rrjeti dhe për të ka pasur testime hidraulike disa herë,
- Janë lëshuar në punë nënstacione të reja, pjesa sekondare e të cilave është mbushur me ujë nga rrjeti primar,
- Janë bërë disa herë testime (mbushje/zbrazje) të rezervuarëve të nxehtësisë të cilët janë pjesë e projektit T-1 (800m³ uji),
- Si procedurë aty ku është e mundur rrjeti sekondar në të gjitha nënstacionet mbushet nga rrjeti primar me ujë të zbutur,

- Zbrazja dhe mbushja e sistemit sekondar të ndërtesave gjatë realizimit të projektit për instalimin e matësve të energjisë termike "Prishtina Heat Save".
- Humbjet e ujit për shkak sanimit të rrjedhjeve në segmente të caktuara të rrjetit.

Në figurën 3 është dhënë Paraqitja grafike e humbjeve të ujit për tre sezonat ngrohëse 2022/'23, 2023/'24 dhe 2024/'25.

Fig. 3 Paraqitja grafike e humbjeve të ujit për tre sezonat ngrohëse të kaluara



Projeksionet e humbjeve të energjisë termike në rrjet

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike (TC Kosova B – NQ Termokos) dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.

Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, parashihet të jenë 2% apo 8,620 MWh_{TH}.

Në vitin 2026, parashihet që niveli i humbjeve të energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes të bie nga 7.5% (që ishte në sezonin e fundit 2024/'25) në 6.75 %.

Në tabelën 12, janë paraqitur detajet për planifikimin e humbjeve në rrjetin e transportit (koogjenerimit TC Kosova B – NQ Termokos) dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2026.

Tabela 12. Humbjet e planifikuara në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike për vitin 2026

HUMBJET NË RRJET - VITI 2026								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	1,407	1,231	1,120	441	477	1,226	1,430	7,332
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportimit (%)	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	4,646	4,066	3,699	1,457	1,572	4,051	4,725	24,216
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes (%)	6.75	6.75	6.75	6.75	6.75	6.75	6.75	6.75
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	6,052	5,297	4,819	1,899	2,049	5,277	6,155	31,548
Total humbjet në rrjet në përqindje (%)	8.75	8.75	8.75	8.75	8.75	8.75	8.75	8.75

Sqarim: Historiku i humbjeve të përgjithshme të energjisë termike për tri vitet e fundit është paraqitur në Tabelën 10, ndërsa në Tabelën 12 është paraqitur projeksioni i humbjeve të energjisë termike për vitin 2026, ndaras për rrjetin e transportit të energjisë termike dhe ndaras për rrjetin e shpërndarjes.

PLANI I FURNIZIMIT TË KONSUMATORËVE ME ENERGJI TERMIKE

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për parashikimin e kërkesës për ngrohje është bazuar në të dhënat historike të konsumit të ngrohjes, karakteristikat e sistemit të ngrohjes qendrore në kuptim të mundësisë për zgjerimin e rrjetit, rritjen e bazës së konsumatorëve, si dhe të kapaciteteve prodhuese të energjisë termike. Gjithashtu, në parashikimin e kërkesës për energji termike janë marrë për bazë projeksionet zhvillimore të NP "Termokos" Sh.A.

Projeksionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NP "Termokos" Sh.A kryesisht përfshijnë planifikimet për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes e rrjedhimisht edhe rritjen e bazës së konsumatorëve / sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes. Ndikimi i rritjes së gjithmbarshme ekonomike gjithashtu vlerësohet përmes indikatorëve të zhvillimit ekonomik.

Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës për energji termike

Parashikimi i kërkesës për energji termike mund të bazohet në kërkesën/ konsumin në rritje në tri sezonet e fundit dhe në planifikimin e zgjerimit të sipërfaqes ngrohëse. Gjithashtu planifikimi i kërkesës merre parasysh shfrytëzimin eficient të energjisë, ku me zbatimin sa me të gjere te faturimit me matje, eshte e pritshme qe te rezultoj me kursim te energjise termike te konsumuar. Në tabelën 13. është paraqitur konsumi i energjisë termike në tri sezonat e fundit.

Tabela 13. Realizimi i konsumit të energjisë në tri sezonat e fundit ngrohëse 2024/2025, 2023/2024 dhe 2022/2023

Sezona	Energjia e Prodhuar nga koogjenerimi	Humbjet ne rrjetin e kogjenerimit		Energjia e prodhuar në Ngrohtoren Termokos	Konsumi vetanak	Energjia e liferuar	Humbjet në rrjetin e shpërndarjes		Humbjet e përgjithshme	
	MWht	MWht	%	MWht	MWht	MWht	MWht	%	MWht	%
2024/25	359,816	7,196	2	0	299.3	325,862	26,458	7.5	33,654	9.4
2023/24	329,617	6,592	2	0	364.7	285,728	36,932	11.4	43,525	13.2
2022/23	308,156	6,163	2	48.03	855.7	270,582	30,603	10.2	36,766	11.9

Sqarim: Arsyeja që konsumi vetanak në sezonën ngrohëse 2024/25 ka qenë më i ulët krahasuar me dy sezonat paraprake, është sepse : në sezonën 2024/25 për dallim nga sezona 2022/'23 , nuk është bërë ngrohja e mazutit në katër rezervuarë. Ndërsa gjatë sezonës ngrohëse 2024/25, temperatura e jashtme mesatare ka qenë më e lartë se nësezonin 2023/2024, e si rrjedhojë edhe shfytëzimi i energjisë termike për konsum vetanak ka qenë më i ulët.

Në sezonat e mëhershme (deri në 10 vjetët e fundit) gjer me funksionalizimin e sistemit të koogjenerimit në vitin 2014, furnizimi me ngrohje nga NP"Termokos" Sh.A nuk ka qenë në nivelin e duhur, prandaj edhe kërkesa për kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore ka qenë e papërfillshme.

Në studimin e Masterplanit 2024(studimi i zgjerimit të rrjetit), janë paraparë kahet e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes, përkatësisht përfshirja e konsumatorëve të rinjë.

Numri i konsumatorëve të rinjë, përveç nga fizibiliteti i zgjerimit të rrjetit në pjesë të caktuara të qytetit, determinohet edhe me kapacitetin energjetik në dispozicion nga sistemi i koogjenerimit, i cili aktualisht është 140MW_{TH}.

Numri i konsumatorëve të rinjë dhe energjia termike e angazhuar për ta, është paraqitur në strategjinë e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit shpërndarës të Termokosit (tre skenarë të zhvillimit).

Për hartimin e këtij Bilanci është marrë për bazë projeksioni (skenari) i mesëm, siç vërehet nga tabela 5, për vitin 2026 është parashikuar një rritje e sipërfaqes ngrohëse të kyçur prej 170,000m².

Ky planifikim për rritje të sipërfaqes ngrohëse është bazuar në subvencionet/donacionet dhe vetfinancim nga Termokosi, për zgjerimin e sistemit të ngrohjes.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës respektivisht furnizimit të konsumatorëve me energji termike i ndarë sipas muajve për vitin 2026.

Tabela 14. Parashikimi i kërkesës/furnizimit për energji termike 2026

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2026									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komercial e Institucional			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	1,456,459.86	102	39,791	842,897.50	76	24,389	2,299,357.36	178	64,180
Shkurt	1,456,459.86	102	35,152	842,897.50	76	21,017	2,299,357.36	178	56,169
Mars	1,456,459.86	102	31,780	842,897.50	76	19,323	2,299,357.36	178	51,103
Prill	1,456,459.86	102	12,118	842,897.50	76	8,016	2,299,357.36	178	20,134
Tetor	1,566,459.86	110	13,053	872,897.50	79	8,664	2,439,357.36	188	21,717
Nëntor	1,566,459.86	110	34,201	872,897.50	79	21,758	2,439,357.36	188	55,959
Dhjetor	1,566,459.86	110	39,899	872,897.50	79	25,376	2,439,357.36	188	65,275
Total / Mes. *	1503602.717	105	205,994	855754.643	77	128,543	2,359,357.36	182	334,537
*Për sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termike llogaritet mesatarja, ndërsa për sasinë e energjisë termike shuma									

Në tabelën më poshtë paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike edhe humbjet në rrjet.

Tabela 15. (Parashikimi i kërkesës për energji termike, energjisë termike dhe humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2026)

KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2026								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	64,180	56,169	51,103	20,134	21,717	55,959	65,275	334,537
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndar. (MWh)	4,646	4,066	3,699	1,457	1,572	4,051	4,725	24,216
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	68,826	60,235	54,802	21,591	23,289	60,010	70,000	358,753

Përmbledhja e bilancit vjetor të energjisë termike për vitin 2026

Tabela 16. Përmbledhje e bilancit vjetor të energjisë termike 2016

BILANCI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË TERMIKE 2026			
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - mazuti	(MWh _{TH})	0
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore	(%)	N/A
3	Prodhiimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	0
4	Prodhiimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	366,590
5	Total Bruto Prodhiimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	366,590
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	7,332
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	2.00%
8	Konsumi vetanak	(MWh _{TH})	505
9	Neto Prodhiimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	358,753
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	24,216
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	6.75%
12	Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	334,537
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	-
14	Sipërfaqja ngrohëse	m ²	2,359,357
15	Numri i nënstacioneve termike	-	935
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	274
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	120

Sqarim: Përmbledhja e bilancit vjetor të energjisë termike për vitin 2026 paraqet edhe Saldon e bilancit vjetor të energjisë termike për vitin 2026.

PLANIFIKIMI I REMONTEVE, RIPARIMEVE DHE MIRËMBAJTJES SË KAPACITETEVE PRODHUESE DHE RRJETIT PËR VITIN 2026

Departamenti i Prodhimit / Koogjenerimit

A-Divizioni i makinerisë

I. 0 Ngrohtorja qendrore (R)

- Remonti i pompave qarkulluese variabile, pompat: 62P₁, 62P₂, 62P₃ dhe 62P₄,
- ndërrimi i kushinetave, puthitësave, boshtit dhe qarkut të pompave, sipas nevojës;
- Ndririmi i valvolave DN500 në degën kryesore të Bregut të Diellit/Ulpianë;
- Kontrollimi dhe testimi i pajisjeve elektrike dhe automatike. Servisimi i vinçit urë në NQ, i cili është i vendosur te pompat qarkulluese të rrjetës së distribuimit.
- Furnizim me valvula siguruese;
- Furnizim me pjesë rezervë për pompat qarkulluese NQ;

I. 1 Stacioni për Ekstraktimin e Nxehtësisë-HES

- Remonti i pompave të kondenzatit 01_00_02RP11D00, sipas nevojës;
- Freskim i motorave të pompave të kondenzatit, sipas nevojës;

- Bazhdarimi i matësve të energjisë, bazuar në marrëveshjen për furnizim me ngrohje KEK- Termokos (i obligues sipas marrëveshjes për energji mes KEK-ut dhe Termokosit);
 - Bazhdarimi i valvolave siguruese;
 - Revizion i valvolave;
- I.2 Stacioni për pranim të nxehtësisë – HRS(r)
- Remont i pompave të koogjenerimit 121_122P001, sipas nevojës;
 - Ndërrimi i diktunave dhe pllakëzave të këmbyesve KN-2 (me shërbim);
 - Bazhdarimi i valvolave siguruese,
 - Revizion i pompave për mbajtje të presionit në rrjetin e koogjenerimit dhe revizioni i paisjes për degasifikim;
 - Kontrollimi dhe testimi i paisjeve elektrike dhe automatike.
 - Revizion i valvolave;
 - Furnizim me pjesë rezervë për sistem të koogjenerimit;
- I.3 Termonënstacioni kryesor i Bregut të Diellit (r)
- Riparimi i filtrave DN350mm, në hyrje të termonënstacionit kryesor të Bregut të Diellit dhe riparimi i filtrit DN400mm në pjesën sekondare të B.D;
 - Remonti i pompave qarkulluese Etanorm, pompës, ndërrimi i kushinetave, sipas nevojës;
 - Servisimi i vinçit urë në termonënstacionin Kryesor Bregu i Diellit.
- I.4 Ngrohtorja e Spitalit
- Revizioni i flakërusve të kaldajave: K1 dhe K2.
 - Ndërrimi i pompës qarkulluese në pjesën e QKUK-së,
- I.5 Rrjeti i koogjenerimit
- Riparimi i izolimeve të gypave në pjesën "Laguna 1 dhe 2", ndërrimi ose riparimi i izolimit,
 - Funkcionalizimi i sistemit të detektimit të rrjedhjeve në rrjet të koogjenerimit (Sipas nevojës ndërrimi i paisjeve për detektim të rrjedhjeve të cilat janë të instaluar në puseta MS)
 - Revizioni i valvave DN600 në pusetat e koogjenerimit,
 - Mirëmbajtja e pusetave.

B-Divizioni i Elektrikës

- Furnizim me pjesë për freskimin elektromotorëve - Prodhim;
- Furnizimi me HMI, programi dhe mundësi të monitorimit në kohë reale të shpenzimit me energji elektrike në prodhim & koogjenerim;
- PC industriale dhe backup i serverit HRS/HES për rezervë;
- Licencimi i softuerëve të kontrollit PLC dhe SCADA;
- Ndërrimi i infrastrukturës elektrike-kabllove, kthinave dhe trafostacioneve të furnizimit me tensionin e mesëm 20kV;
- Pjesë rezervë për elektrikë dhe automatikë;
- Shpenzimet lidhur me shqyrtimin e fuqisë dielektrike të trafave 10KV, tokëzuesi dhe rrufepriti (Ngrohtore e spitalit & st. Bregu i Diellit);

- Analizat & filtrimi & përforcimi i vajit izolues për TR1&TR2 dhe intervenim në tokëzimin e rufepritësit në HRS bashkë me matjen e rezistencës;
- Studim fizibiliteti, inspektim bashkë me rekomandime për ndryshimet e nevojshme në elektrikë&automatikë brenda NP. Termokos;
- Suport i jashtëm për probleme komplekse dhe editime në sftvuerin PLC-së dhe SCADA.

C-Divizioni i PKU-së

- Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë në stacionin HRS;
- Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë nga njësitë e terenit (distribuimit) sipas kërkesës;
- Servisimi i zbutësave të vjetër të distribuimit;
- Instalimi i zbutësave të ri për rrjet të distribuimit;
- Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë në termonënstacionin Kryesor Bregu i Diellit.

*Sqarim:

Për kaldajat K-1 dhe K-2, nuk kemi paraparë ndonjë aktivitet për vitin 2026 sepse janë jashtë funksionit. Sipas rekomandimit nga ekspertët nga FIM, për shkak të vjetërsisë së gypave dhe përdorimit të lëndës djegëse mazut, rekomandojnë që të investohet në instalimin e kaldajave të reja me lëndë djegëse gas.

Për termonënstacion të mazutit (të vjetrin) nuk kemi paraparë ndonjë plan të mirëmbajtjes për vitin 2026, sepse stacioni i mazutit i vjetër është larguar për shkak të ndërtimit të objektit të ri administrativ.

Departamenti i Distribuimit

a) Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore

Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore në vitin 2026, është planifikuar të bëhet në lagjen Lakrishtë, për të cilën janë duke u zhvilluar punimet.

b) Rehabilitimi i rrjetit

- Plani më i saktë për rehabilitim do të përpilohet para përfundimit të sezonës, atëherë kur bëhet edhe hartimi i Planit Aksional. Në këtë rast do të përfshihen të gjitha pikat kritike, të evidentuara gjatë sezonës. Materialet për këtë aktivitet do të përpilohen para kërkesës për furnizim me gypa. Mjetet për këtë aktivitet janë të planifikuara me buxhetin e vitit 2026.

c) Rehabilitimi/modernizimi nënstacioneve ekzistuese

- Në vitin 2026 do të bëhen intervenime standarde në të gjitha nënstacionet:
 - Kontrollimi dhe ndërrimi eventuale i valvolave rregulluese;
 - Kontrollimi dhe ndërrimi eventuale i pompave qarkulluese;
 - Kontrollimi dhe pastrimi kimik, sipas nevojës, i këmbyesve të nxehtësisë;

- Kontrollimi, pastrimi dhe ndërrimi sipas nevojës i filtrave në rrjetin primar dhe sekondar;
- Kontrollimi i rrjetit sekondar në objekte dhe nënstacione, intervenim sipas nevojës.

Tabela 17. Planifikimi i riparimeve dhe remonteve -2026

PLANIFIKIMET E RIPARIMEVE, REMONTEVE DHE MIRËMBAJTJEVE NË VITIN 2026													
Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total muajt
Njësia e prodhimit të En. Term.													
Gjeneratori U1						r		r	r				
Gjeneratori Un						r		r	r				
Njësia prodhuese në ngrohtore					r	r		r	r				
Rrjeti dhe nënstacionet				R	R,r	R,r	R	R,r	R,r	R,r			
Total R, r				R	R,2r	R,4r	R	R,4r	R,4r	R,r			

R' i referohet Remonteve, Riparimeve Madhore; 'r' i referohet remonteve dhe riparimeve të zakonshme

Emetimi i ndotësve të ajrit nga impiantet e prodhimit të energjisë termike

Meqenëse impiantet për prodhimin e energjisë termike të instaluar në NP "Termokos" Sh.A, (dy kaldajat me mazut me kapacitet 116MWTH), nuk janë funksionale (të vlerësuara nga ekspertët e angazhuar nga FM dhe FN të Universitetit të Prishtinës, e sqaruar në faqen 7. të këtij dokumenti), gjithashtu dhe stacioni i mazutit (i vjetëri) është larguar për shkak të ndërtimit të objektit të ri administrativ, për vitin 2026 nuk është planifikuar prodhim i energjisë termike nga mazuti. Rrjedhimisht nuk është parashikuar as emetimi i ndotësve të ajrit CO₂ dhe SO₂, nga prodhimi me mazut në kaldajat e ngrohtores "Termokos".

Duke qenë se për vitin 2026 është planifikuar prodhimi i energjisë termike vetëm nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, janë përlllogaritur vetëm emitimet e CO₂ të liruara nga linjiti gjatë prodhimit të kësaj energjie.

Emitimet e parashikuara të CO₂ nga impiantet e kogjenerimit në termocentralin "Kosova B" nëpër muaj, janë paraqitur në tabelën 18.

Tabela 18. Sasia e emetimit të gazrave CO₂ nga kogjenerimi për vitin 2026

EMETIMET E PARASHIKUARA TË CO ₂ PËR VITIN 2026		
Muajt	Prodhi brutë e energjisë termike nga kogjenerimi	Emetimi i CO ₂ nga kogjenerimi (me linjit)
	MWh	ton
Janar	87,028	8,570
Shkurt	70,446	6,937
Mars	65,271	6,428
Prill	23,829	2,347
Tetor	26,940	2,653
Nëntor	70,446	6,937
Dhjetor	87,027	8,570
Total	430,987	42,442
Emitimet për njësi energjisë së prodhuar (0.646 tCO ₂ /MWh)- linjit		

Prandaj, fakti që NP "Termokos" Sh.a nuk krijon ndotje të mjedisit, ka ndikim jashtëzakonisht pozitiv në ambient dhe në shëndetin publik, duke pasur parasysh që NP "Termokos" Sh.A. ndodhet në pjesën e urbanizuar të qytetit.